

L I G J
Nr.8465, datë 11.3.1999

PER NDËRMJETËSIMIN PËR ZGJIDHJEN ME PAJTIM TË MOSMARRËVESHJEVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ndërmjetësimi është veprimtari jashtëgjyqësore, që realizohet nga nje person i tretë (ndërmjetësi), për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve ndërmjet shtetasve, ndërmjet tyre dhe subjekteve juridikë, privatë, ose ndërmjet këtyre të fundit, sipas kushteve të parashikuara në këtë ligj.

Ndërmjetësimi ka për qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme prej palëve në konflikt, që nuk vjen në kundërshtim me ligjin e me zakonet e mira.

Në kuptim të këtij ligji, nuk mund të zgjidhen me ndërmjetësim mosmarrëveshjet, për të cilat është e detyrueshme zgjidhja në rrugë gjyqësore.

Ky ligj nuk përjashton veprimtaritë, të cilat kanë si qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim të subjekteve ose në forma të tjera, por pasojat juridike të parashikuara prej tij, vijnë vetëm për ndërmjetësimin në kuptim të këtij ligji.

Neni 2

Ndërmjetësimi për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve është veprimtari shoqërore, e pavarur dhe ushtrohet në përputhje me këtë ligj.

Neni 3

Ndërmjetësimi për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve bazohet në barazinë e palëve, në respektimin e vlerave individuale dhe në paanësinë për zgjidhjen e çështjes.

Neni 4

Ndërmjetësimi është vullnetar. Palët në mosmarrëveshje janë të lira të zgjedhin ndërmjetësin, si një mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të përcaktuara në këtë ligj.

Në rastet kur në një çështje konkrete ndërmjetësi i caktuar ka interesa ose lidhje me ndonjerën nga palët në konflikt, duhet të heqë dorë nga ndërmjetësimi, në të kundërt marrëveshja nuk sjell pasojat juridike që parashikohen në këtë ligj.

Neni 5

Ndërmjetësimi ka karakter konfidencial.

Bisedimet e zhvilluara nga palët gjatë ndërmjetësimit dhe dokumentacioni përkatës nuk mund të bëhen publike, pa miratimin e tyre.

Neni 6

Ndërmjetësimi është një proces edukimi, i dyanshëm, që ka si qëllim të parandalojë zgjidhjet gjyqësore të mosmarrëveshjeve dhe të zbusë pasojat sociale të tyre, të harmonizojë interesat e palëve, duke krijuar mirëkuptim ndërmjet tyre.

Ndërmjetësimi ka si qëllim të kapërcejë pasojat që lindin në grupet shoqërore, si rrjedhojë e veprave penale ose e mosmarrëveshjeve të tjera.

Neni 7

Ndërmjetësimi kryhet pa shpërblim.

Në rast se gjatë veprimeve të ndërmjetësimit parashikohet të bëhen shpenzime, në ngarkim të palëve, duhet marrë paraprakisht pëlqimi me shkrim i tyre, për vlerën dhe mënyrën e pagimit. Palët përballojnë shpenzimet, në mënyrë të barabartë, përveç rasteve kur merren vesh ndryshe.

Neni 8

Ndërmjetësimi në kuptim të këtij ligji, mund të ushtrohet nga organizata joqeveritare, të cilat e kanë në objektin e veprimtarisë së tyre ndërmjetësimin.

Organizatat joqeveritare mund të ushtrojnë veprimtari ndërmjetësimi, në kuptim të këtij ligji, pas miratimit paraprak nga Ministri i Drejtësisë dhe pas regjistrimit të tyre në gjykatë.

Neni 9

Organizatat joqeveritare, në funksion të realizimit të ndërmjetësimit, kujdesen dhe ndjekin veprimtaritë si vijon:

- a. Zgjedhin dhe regjistrojnë ndërmjetësit në gjykatë;
- b. kërkojnë çregjistrimin e ndërmjetësve, kur kanë pengesë ligjore ose kur nuk u përgjigjen qëllimeve të ligjit për ndërmjetësimin;
- c. organizojnë veprimtari për aftësimin dhe ndjekin rregullsinë e veprimtarisë së ndërmjetësuesve;
- ç. ndërmarrin studime për mosmarrëveshjet, objekt i këtij ligji, dhe rekomandojnë marrjen e masave përkatëse nga organet shtetërore;
- d. zhvillojnë veprimtari publicistike për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve;
- dh. organizojnë, në shkolla dhe institucione arsimore, veprimtari për përgatitjen e grupmoshave me njohuritë e ndërmjetësimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- e. organizojnë, vetëm ose në bashkëpunim, veprimtari për edukimin e njerëzve me frymën e mirëkuptimit, të tolerancës dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me pajtim.

Neni 10

Ndërmjetësimi zbatohet për mosmarrëveshjet familjare, që kanë të bëjnë me:

- a. bashkëjetesat dhe martesat;
- b. mospërmblidhjen e detyrimeve për ushqim;
- c. mosrealizimin e detyrimeve, që rrjedhin nga e drejta prindërore;
- ç. pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore;
- d. shkaqe të tjera, për të cilat palët kërkojnë ndërmjetësim.

Neni 11

Ndërmjetësimi zbatohet për mosmarrëveshjet civile, ndërmjet subjekteve private, që rrjedhin nga:

- a. mohimi ose cenimi i së drejtës së pronësisë ose nëdorësisë;
- b. shkaktimi i dëmit;
- c. raste të tjera, për të cilat palët kërkojnë ndërmjetësim për pajtim.

Neni 12

Ndërmjetësimi për zgjidhjen me pajtim zbatohet edhe për:

- a. veprat penale, që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, në bazë të nenit 59, të Kodit të Procedurës Penale;
- b. veprat penale, për të cilat ndjekja penale mund të fillojë vetëm në bazë të ankimit të të dëmtuarit, në bazë të nenit 284, të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 13

Në rastet kur gjykata ose prokuroria për çështjet e parashikuara në nenet 10, 11 dhe 12 të këtij ligji, çmon se konflikti mund të zgjidhet me ndërmjetësim dhe palët nuk kanë kundërshtim, pezullon shqyrtimin e çështjes dhe ia dërgon çështjen për shqyrtim, ndërmjetësit.

Në qoftë se mosmarrëveshja nuk zgjidhet me ndërmjetësim, atëherë kjo nuk e ndalon gjykatën apo prokurorinë të rifillojë procedimin ligjor me kërkesën e palëve.

Neni 14

Ndërmjetësimi, në varësi të natyrës së mosmarrëveshjes apo nga kërkesa e palëve realizohet nga një ose disa ndërmjetës.

Ndërmjetësi pranohet vullnetarisht nga palët e interesuara.

Neni 15

Ndërmjetës mund të jetë çdo person, që ka mbushur moshën 25 vjeç, si rregull, me arsim të lartë, që nuk ka qenë i dënuar penalisht, i njohur për ndershmëri, urtësi, mençuri, që gëzon besimin e njerëzve dhe ka një përvojë në veprimtaritë shoqërore.

Neni 16

Ndërmjetësi caktohet ose hiqet nga organizata përkatëse joqeveritare, duke u këshilluar edhe me organet e drejtësisë dhe ato të pushtetit lokal.

Emrat e ndërmjetësve depozitohen në gjykatë dhe në organin e prokurorisë.

Caktimi i ndërmjetësit bëhet me miratimin e kërkesës së tij. Në aktmarrëveshjen, që hartohet për këtë qëllim, përcaktohen të drejtat e detyrimet e tij dhe të organizatës joqeveritare.

Ndërmjetësi, si rregull, zhvillon veprimtarinë e vet në territorin e caktuar në aktmarrëveshje, për një afat dyvjeçar, me të drejtë ripërtëritjeje.

Neni 17

Ndërmjetësi realizon zgjidhjen e mosmarrëveshjeve:

- a. duke diskutuar, paraprakisht, me palët për natyrën dhe shkaqet e mosmarrëveshjes;
- b. duke parashtruar mundësira për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, pa ua imponuar palëve mendimet e tij;
- c. duke bashkëpunuar me organet e drejtësisë, me ato të rendit, të pushtetit lokal,

Avokatit të Popullit, dhe me organizatat joqeveritare për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve;

ç. duke u kërkuar organeve kompetente shtetërore marrjen e masave për të shmangur shkaqet e kundërligjshme apo veprimet e parregullta të nëpunësve publikë, të cilat kanë ndikuar në mosmarrëveshje dhe, duke i vënë në dukje sipas rastit edhe përgjegjësitë e tyre.

Ndërmjetësi nuk mund të thirret si dëshmitar, nga gjykata ose prokuroria, për faktet për të cilat ka patur dijeni, në çështjet që ka ndërmjetësuar për pajtim, përveç rasteve kur gjatë procesit të ndërmjetësimit, është kryer një vepër penale.

Neni 18

Aktmarrëveshja përmban detyrimet dhe kushtet, që palët i vënë njëra-tjetrës, mënyrën dhe afatin e përmbushjes së tyre, nënshkrimin e palëve dhe atë të ndërmjetësit.

Aktmarrëveshja lidhet ndërmjet palëve me shkrim, me përjashtim të rasteve kur nuk është e domosdoshme për vetë natyrën e mosmarrëveshjes

Neni 19

Aktmarrëveshja hartohet të paktën në tri kopje, një për secilën palë dhe një kopje depozitohet nga ndërmjetësi në organizatën joqeveritare, së cilës i përket. Organizata është e detyruar të ruaj dhe të administrojë aktmarrëveshjen dhe dokumentacionin në lidhje me të.

Neni 20

Ndërmjetësi fillon ndërmjetësimin në bazë të kërkesave të shtetasve të interesuar, si dhe të çështjeve të dërguara nga prokuroria dhe gjykata.

Neni 21

Kompetent për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve, si rregull, është ndërmjetësi, që banon në vendin e banimit ku ndodhen të dyja palët.

Në rastet kur palët e interesuara janë banues në vende të ndryshme, si rregull, ndërmjetësimi bëhet nga ndërmjetësi, që banon në të njëjtin vend ku banon personi kundër të cilit është ngritur pretendimi.

Kompetencat e mësipërme mund të ndryshohen me marrëveshjen e palëve.

Neni 22

Ndërmjetësimi realizohet në praninë e të dyja palëve.

Kur njëra nga palët është person juridik, kjo përfaqësohet nga personi i autorizuar, në mënyrë të posaçme prej tij.

Neni 23

Aktmarrëveshja zbatohet vullnetarisht nga palët, sipas përmbajtjes së saj, në të kundërt palët kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e saj, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 24

Ndërmjetësi, brenda 45 ditëve nga data që i është dërguar çështja nga gjykata ose

prokuroria, njofton ato për zgjidhjen ose jo të mosmarrëveshjes duke dërguar edhe aktet përkatëse.

Në rastin kur është zgjidhur çështja me anë të ndërmjetësimit, organet gjyqësore e të prokurorisë vendosin pushimin e çështjes, penale a civile, ose refuzimin e fillimit të procedimit penal, si dhe bëjnë shënimet në regjistrat përkatës, përveç rasteve kur konkludohet ose konstatohet pavlefshmëri.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim, në të cilat parashikohen detyrime në të holla, dorëzim sendesh, ose në kryerjen e shërbimeve të vlerësueshme, e dokumentuar me shkrim, mund të kundërshtohet brenda 10 ditëve në organin kompetent, në të kundërt aktmarrëveshja përbën titull ekzekutiv, në bazë të nenit 510, të Kodit të Procedurës Civile.

Kur bëhet kundërshtim, gjykata apo prokuroria marrin në konsideratë mënyrën e zgjidhjes me ndërmjetësim, por nuk kanë pengesë ligjore për zgjidhje tjetër, në përputhje me ligjin.

Neni 25

Gjykata ose prokuroria mund ta konsiderojnë të pavlefshme marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim, kur konkludojnë se nuk pasqyron vullnetin e palëve në konflikt, kur janë cenuar rëndë të drejtat dhe interesat e tyre, ose kur zhdëmtimi është haptazi në disproporcion me dëmin e shkaktuar.

Neni 26

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim, në kuptim të këtij ligji, është e pavlefshme në rastet si vijon:

a. realizohet nga persona, që nuk janë ndërmjetës ose nuk duhet të jenë të tillë sipas këtij ligji;

b. mosmarrëveshja, sipas ligjit, duhet zgjidhur vetëm në rrugë gjyqësore;

c. përmban detyrime të vlerësueshme në të holla dhe nuk formulohet me shkrim;

ç. përmban detyrime për subjekte, që nuk kanë marrë pjesë në ndërmjetësim;

d. ka simulim dhe, për konfliktin real, ka shkaqe pavlefshmërie.

Pavlefshmëria e marrëveshjes së ndërmjetësimit, sipas këtij ligji, nuk i pengon palët në konflikt që të realizojnë marrëveshjen e arritur, duke ushtruar të drejtat, që gëzojnë me ligje të tjera.

Neni 27

Fondet për ndërmjetësimin përballohen nga buxheti i shtetit i caktuar për organizatat joqeveritare, nga donatorët, nga palët dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Neni 28

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2335, datë 19.3.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**